



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0095268/22-19 dt. 26.10.2022

Mitrovicë

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/15, qershor 2008); nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, nenin 18 paragrafi 1, nënparagrafi 1.11 dhe nenin 46 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Statutit të Komunës; nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 3, të Rregullores Nr. 11/2013 për subvencione dhe transfere, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 26.10.2022, pasi shqyrtoi Propozimin për subvencionimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara; sjell këtë:

VENDIM

Për subvencionimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara

1. MIRATOHET Vendimi për subvencionimin të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Komunën e Mitrovicës së Jugut.
2. Sipas pikës 1, të këtij vendimi 1,100.00 (njëmijënjëqind) € ndahen për fëmijët me aftësi të kufizuara në Komunën e Mitrovicës së Jugut, të cilët vijnë jashtë territorit të Komunës së Mitrovicës, sipas evidencës së Drejtorisë së Arsimit ku edhe të njëjti duhet të aplikojnë.
3. Mjetet e lejuara sipas pikës 2, të këtij vendimi ipen nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere të Zyrës së Kuvendit dhe paguhen në xhironlogaritë personale të aplikuesve të cilët i plotësojnë kushtet sipas pikës 2 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës, Kryesuesja e Kuvendit, Drejtorja për Arsim dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit

1 x 1 MAP

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

Drejtorisë për Arsim

Drejtorisë për Buxhet dhe Financa